



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 15 janar 2013
Nr. ref.: RK343/13

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastin nr. KI 104/12

Parashtruesit

**Azem Kabashi
Tahir Badalli
Osman Zajmi
Nafije Krasniqi**

Vlerësim i kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë së listës përfundimtare të 20%-it të ardhurave të shitjes nga privatizimi i Ndërmarrjes Shoqërore “Industria Ushqimore” hartuar nga Agjencia Kosovare e Privatizimit

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar
Ivan Čukalović, Zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare,
Kadri Kryeziu, gjyqtar, dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesit e kërkesës

1. Kërkesa u parashtrua nga z. Azem Kabashi, me vendbanim në Korishë, fshat në Prizren, z. Tahir Badalli, me vendbanim në Zhur, fshat në Prizren, z. Osman Zajmi, me vendbanim në Prizren dhe znj. Nafije Krasniqi, me vendbanim në Prizren.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesit e kontestojnë listën e punëtorëve të kualifikueshëm për 20%-in nga të ardhurat e shitjes së Ndërmarrjes Shoqërore "Industria Ushqimore", Prizren, (në tekstin e mëtejshëm: NSH) të Agjencisë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejshëm: "AKP").

Objekti i çështjes

3. Parashtruesit pretendojnë se AKP-ja i ka interpretuar në mënyrë të gabueshme dispozitat e neneve 10.1, 10.2 dhe 10.4 të Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2003/13 për Transformimin e së drejtës për përdorimin e pronës së patundshme në pronësi shoqërore (në tekstin e mëtejshëm: Rregullorja e UNMIK-ut Nr. 2003/13).
4. Parashtruesit nuk i referohen asnjë dispozite të Kushtetutës.

Baza juridike

5. Neni 113.7 i Kushtetutës, neni 22 i Ligjit Nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, i 15 janarit 2009, (në tekstin e mëtejshëm: Ligji), dhe rregulli 56 (2) i Rregullores së Punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Rregullorja e Punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

6. Më 19 tetor 2012, Parashtruesit dorëzuan në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës ((në tekstin e mëtejshëm: "Gjykata") propozimin për vlerësimin e kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë së listës së AKP-së të punëtorëve të kualifikueshëm për 20%-in nga të ardhurat e shitjes së NSH-së.
7. Më 23 tetor 2012, Gjykata kërkoi nga parashtruesit që ta plotësojnë kërkesën në pajtim me rregullin 36.4 të Rregullores së punës, i cili parasheh: *"Nëse kërkesa është e pakompletuar ose nuk përmban informacione të domosdoshme për zhvillimin e procedurave, Gjykata kërkon nga parashtruesi t'i bëjë përmirësimet e domosdoshme brenda një afati të caktuar kohor, por jo më shumë se 30 ditë."* Parashtruesit nuk parashtruan asnjë përgjigje në këtë kërkesë.
8. Më 5 nëntor 2012, Kryetari i Gjykatës Kushtetuese me Vendimin Nr.GJR.KI-104/12, caktoi Gjyqtarin Robert Carolan si Gjyqtar Raportues. Të njëjtën datë, Kryetari i Gjykatës Kushtetuese me Vendimin Nr. KSH.KI-104/12, caktoi Kolegjin Shqyrtues të përbërë nga Gjyqtarët: Altay Suroy (gjyqtar kryesues), Kadri Kryeziu dhe Arta Rama-Hajrizi.
9. Më 8 nëntor 2012, kërkesa iu komunikua AKP-së.
10. Më 6 dhjetor 2012, pasi shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues, Kolegji Shqyrtues i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhje e fakteve

11. Më 19 tetor 2012, parashtruesit dorëzuan kërkesën me vetëm pesë faqe të përbërë nga:
 1. Propozimi për vlerësim të kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë së listës përfundimtare të 20 %-it, të hartuar nga Agjencia Kosovare e Privatizimit; 2. Lista e AKP-së e punëtorëve të kualifikueshëm për 20%-in nga të ardhurat e shitjes së NSH-së, të publikuar në gazetën ditore Kosova Sot; dhe 3. Rregullorja e UNMIK-ut 2003/13.

Pretendimet e Parashtruesve

12. Parashtruesit pretendojnë se AKP-ja i ka interpretuar dhe aplikuar në mënyrë të gabueshme dispozitat e neneve 10.1, 10.2 dhe 10.4 të Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2003/13, kur i ka hequr parashtruesit nga lista e punëtoreve të kualifikueshëm për 20% nga të ardhurat e shitjes së NSH-së, sepse nuk i kishin tre vite përvojë pune në NSH. Në vend të kësaj, ata pretendojnë se AKP-ja i ka futur në listë katër punëtorë tjerë, të cilët nuk kanë punuar fare në NSH.
13. Parashtruesit pretendojnë se ata kanë punuar në NSH prej 2001 deri më 2011 dhe se ata i kanë plotësuar kushtet nga nenet 10.1, 10.2 dhe 10.4 të Rregullores së UNMIK-ut 2003/13.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

14. Gjykata vëren se, për të qenë në gjendje të gjykojë për kërkesën e parashtruesve, Gjykata Kushtetuese duhet së pari të shqyrtojë nëse parashtruesit e kërkesës i kanë plotësuar të gjitha kushtet e pranueshmërisë të përcaktuara me Kushtetutë, dhe të specifikuara më tej në Ligj dhe në Rregulloren e punës.
15. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 113.1 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, që parasheh se *“Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.”*
16. Gjykata gjithashtu i referohet rregullit 29 (2) (Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve) që parasheh se: *“(2) Kërkesa po ashtu duhet të përmbajë edhe: (a) emrin dhe adresën e palës e cila e parashtron kërkesën; (b) emrin dhe adresën e përfaqësuesit për dorëzimin e dokumenteve, nëse ka; (c) autorizimin për përfaqësuesin ligjor, nëse ka; (d) emrin dhe adresën e palës ose të palëve kundërshtare, nëse janë të njohura, të cilave u dërgohen dokumentet; (e) mbrojtjen juridike të kërkuar; (f) përmbledhje të shkurtër të fakteve; (g) arsyetimin procedural dhe substantiv të kërkesës; dhe (h)) informacionet dhe dokumentacionin mbështetës.”* Për më tepër, sipas rregullit 29 (3) parashihet se: *“(3) Kërkesës i bashkëngjiten kopjet e çfarëdo dokumenti relevant për të mbështetur atë. Nëse vetëm disa pjesë të dokumentit janë të rëndësishme atëherë sipas nevojës, duhet të bashkëngjiten vetëm pjesët e tilla.”*
17. Në rastin konkret, parashtruesit nuk kanë:
 - a. dorëzuar asnjë dokumentacion mbështetës nëse ata i kanë shteruar të gjitha mjetet ligjore;
 - b. mbështetur me prova në baza kushtetuese; dhe
 - c. ofruar ndonjë provë se të drejtat dhe liritë e tyre janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.
18. Rrjedh se kërkesa është e papranueshme sepse është qartazi e pabazuar sipas rregullit 36 (2) të Rregullores së punës i cilia përcakton se: *(2) Gjykata do të refuzojë një kërkesë si qartazi të pabazuar nëse bindet se: a) kërkesa nuk arsyetohet prima facie, ose b) faktet e paraqitura në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin për shkeljen e një të drejte kushtetuese, ose c) Gjykata gjen se parashtruesi nuk është subjekt i ndonjë shkeljeje të së drejtave të garantuara me Kushtetutë, ose d) kur parashtruesi nuk dëshmon në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij.”*

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me rregullin 36 (2) dhe rregullin 56 (2) të Rregullores së punës, më 6 dhjetor 2012, njëzëri


VENDOSI

- I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme;
- II. Ky vendim do t'u komunikohet palëve dhe do të botohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese; dhe,
- III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues


Robert Carolan

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese


Prof. dr. Enver Hasani

